



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

(PROJEKT)

(Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2020)

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E NËNPRODUKTEVE TË KAFSHËVE, QË  
NUK SYNOHEN PËR T'U KONSUMUAR NGA NJERIU<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

*Neni 1*  
*Qëllimi*

Ky vendim ka si qëllim të përcaktojë:

- a) normat e trajtimit dhe të kontrollit zyrtar që i përkasin nënprodukteve me orgjinë shtazore dhe produkteve derivateve që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit;
- b) normat e mbrojtjes së sigurisë në zinxhirin ushqimor dhe të ushqimeve për kafshë;
- c) normat e trajtimit të nënprodukteve shtazore dhe derivatet e tyre si dhe
- ç) rregullat, detyrat dhe mënyrën e ushtrimit të kontrollit zyrtar, gjatë gjithë procesit të përpunimit, magazinimit, shpërndarjes dhe tregtimit dhe eliminimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate.

*Neni 2*  
*Fusha e zbatimit*

Ky vendim zbatohet për:

- a) nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate të cilat janë përjashtuar nga konsumi për njerëzit në zbatim të legjislacionit;
- b) produkte me origjinë shtazore që janë të destinuara për konsum nga njerëzit por që në një fazë përpunimi të caktuar humbasin cilësinë e ushqimit për njerëz shëndrohen në nënprodukte me origjinë shtazore.
- c) mbetjet me prejardhje nga nënproduktet shtazore dhe derivatet e tyre.

<sup>1</sup> Ky vendim transponon pjesërisht rregulloren 1069/2009 "Rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e përfuara prej tyre jo të destinuara për konsum njerëzor" e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 Tetor 2009. Numri CELEX 32009R1069; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr.300; date 14.11.2009; faqe 1-33; dhe rregulloren 142/2011 dhe Komisionit, dt. 25 shkurt 2011 "Që përmban mënyrat e aplikimit të rregullores (KE) nr. 1069/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e cila përmban normat sanitare përsa i përket nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit. Numri CELEX 32011R0142; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr.54; date 25.02.2011; faqe 1"

ç) operatorët e biznesit që prodhojnë, përpunojnë, grumbullojnë, magazinojnë, tregtojnë, transportojnë dhe eliminojnë nënprodukte me origjinë shtazore dhe mbetje me origjinë shtazore.

Ky vendim nuk zbatohet për rastet e përshkruara në pikën 2, të nenit 2 të shtojcës së parë të këtij vendimi

### *Neni 3* *Përkufizime të përgjithshme*

Termet e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. “Autoritetet kompetente” janë:
  - a) “Struktura përgjegjëse për veterinarinë”, sipas përkufizimit të pikës 5/1 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - b) “Autoriteti kompetent”, sipas përkufizimit të pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - c) “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë”, sipas ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.
  - ç) “Autoritet kompetent për PIK” ,sipas përkufizimit të pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 “për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - d) Institucioni përgjegjës për licencimin e instalimeve të trajtimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, është është struktura përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet, licencat dhe autorizimet.
  - dh) Institucioni përgjegjës për inspektimin dhe monitorimin e instalimeve të trajtimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, është struktura përgjegjëse e inspektimit që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
2. “identifikim”, çdo numër, çdo etiketë, çdo mjet tjetër i cili futet në nënproduktin shtazor i ngjitet, i lidhet dhe shërben për të identifikuar vetë nënproduktin, produktin, materialin me origjinë shtazore, kontejnerin ose mjetin e transportit si njësi unike, e vetme dhe që nuk mund të ngatërrohet ose të këmbehet për një tjetër.
3. “Impiant i djegies”, impiant i incenerimit sipas përkufizimit të pikës 13, neni 3 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
4. “Impiant i djegies për prodhimin e energjisë”, impiant i bashkëincenerimit sipas përkufizimit të pikës 14, neni 3 i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
5. “Fermë e mbarështimit të kafshëve”, sipas përkufizimit të pikës 19 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. “kompostim”, procesi i transformimit të materialeve biologjike në prani të mikroorganizmave dhe oksigjenit.

7. "licencim", është licenca sipas përcaktimit të gërmës gj) nenit 3 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
8. "kafshë për prodhimin e gëzofit", kafshë e cila mbarështohet me qëllim përfitimin e lëkurës për prodhimin e gëzofit.
9. "kafshë shoqërimi" sipas përkufizimit të pikës 33 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
10. "kontroll zyrtar" sipas përkufizimit të pikës 44 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".
11. "kafshë për mbarështim" kafshë fermës sipas përkufizimit të pikës 28 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".
12. "karakteristika organo-leptike", janë karakteristikat e ngjyrës, konsistencës, tingullit, shijes dhe aromës së produkteve shtazore.
13. "markim" çdo substancë, material fizik ose mikroorganizëm biologjik që hidhet dhe përzihet me një material me origjinë shtazore dhe që merr pjesë në procesin e përpunimit por nuk ndërhyr në proces dhe nuk pëson ndryshim të asnjë natyre, por shërben për të matur një tregues të përpunimit ose për të bërë të mundur që një material të mos mund të përdoret për qëllime të ndryshme nga ai për të cilin është prodhuar.
14. "mbetje me origjinë shtazore", janë mbeturina me origjinë shtazore sipas përkufizimit të pikës 53 të nenit 4 të ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
15. "operatorë të biznesit" janë personat fizikë ose juridikë, sipas përcaktimit të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.
16. "sasi të vogla", sasi me të vogla se 100 kg që shpërndahen në treg në nivel lokal.
17. "treg në nivel lokal", tregtimi i materialeve brenda territorit të një qarku sipas ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo territoriale të njësisive të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
18. "transport rifuxho" transporti i mallit me mjete transporti i pa paketuar ose/dhe ambalazhuar më parë. KarrocERIA e mjetit të transportit shërben si kontejner unik.
19. "TSE (Encefalopatia Spungiforme e Transmetueshme)", sëmundje e metabolizmit që prek kafshët.
20. "TRACES (TRAdE Control and Expert System)" Sitem elektronik për kontrollin e mallrave në kufi, me vëndet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vëndet e treta, të cilat kërkojnë certifikate veterinarë. Shqipëria është pjesë e sistemit.
21. "vëndet anëtare të marrëveshjes CEFTA", vëndet e treta të cilat janë kandidatë për antarësim në Bashkimin Evropian dhe që kanë nënshkruar marrëveshjen Cefta (*Central European Free Trade Agreement*). Shqipëria është anëtare me të drejta të plota.

#### *Neni 4*

#### *Rregullat për prodhimin, përpunimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe eliminimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate.*

1. Rregullat për prodhimin, përpunimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe eliminimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate përcaktohen sipas shtojcës 1 dhe 2 të këtij vendimi.

2. Parashikimet e nenit 55, 20, 23, 34, 47, 48, neni 51bis, neni 52, neni 55 dhe neni 56 i Shtojcës së parë; dhe pika 3 neni 10, neni 16, neni 20 bis, neni 29, neni 29 bis, neni 30, neni 36, neni 37, kapitulli 1 aneksi II, seksioni 2 dhe 3 të kapitullit II, aneksi VI, kapitulli V i aneksit IX, seksioni 11, kapitulli II i aneksit XIV të shtojcës së dytë, zbatohen sipas marrëveshjeve mes Republikës së Shqipërisë dhe BE.

#### *Neni 5*

##### *Licencimi i stabilimenteve ose/dhe impianteve .*

1. Operatorët e biznesit që prodhojnë, transportojnë, përpunojnë, fusin në treg, shpërndajnë, magazinojnë, përdorin dhe asgjësojnë nënprodukte shtazore dhe produkte derivate si dhe mbetje me origjinë shtazore licencohen sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat si dhe plotësojnë kërkesat teknike të këtij vendimi si vijon:
  - a) plotësimin e kërkesave sipas nenit 23, të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
  - b). Për tipet e impianteve dhe stabilimenteve sipas përcaktimeve në nenin 24, të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
2. Operatorët e biznesit të licencuar për prodhimin, përpunimin, magazinimin, transportin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore për konsum për njerëz, në rast se duan t'i përpunojnë vetë ose/dhe t'i eliminojnë vetëm nëpërmjet djegies në inceneratorë në pronësi të tyre nënproduktet me origjinë shtazore që prodhojnë vetë ata (kur ato dëmtohen, prishen, skadojnë, nuk shiten, teprojnë ose konfiskohen gjatë kontrolleve zyrtare,) licencohen edhe për përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve, sipas kërkesave të pikës 1, të këtij neni.
  - a) Operatorët e biznesit të licencuar për prodhimin, përpunimin, magazinimin, transportin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore për konsum për njerëz, të cilët nuk kërkojnë që ti përpunojnë ose/dhe eliminojnë vetë nënproduktet shtazore që prodhojnë (kur ato dëmtohen, prishen, skadojnë, nuk shiten, teprojnë ose konfiskohen gjatë kontrolleve zyrtare,) lidhin një kontratë me një impiant ose stabiliment të licencuar sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni, për përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore.
  - b) Operatorë të biznesit ushqimor që nuk e kanë detyrim licencimin, pasi janë biznese të vogla sipas legjislacionit në fuqi dhe kryejnë aktivitet ekonomik në prodhimin, përpunimin, magazinimin, transportin dhe tregtimin e ushqimeve me origjinë shtazore për konsum nga njerëzit, lidhin kontratë me një impiant të licencuar sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni për përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve shtazore.
3. Fermat e mbarështimit të kafshëve, të cilat prodhojnë edhe ushqime me origjinë shtazore për konsum nga njerëzit, duke përdorur si lëndë të parë produkte shtazore që prodhojnë vetë ato:
  - a) plotësojnë kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, sipas rastit.
  - b) nuk pajisen me licensë dhe nuk lidhin kontratë me operatorë të licensuar për përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore vetëm fermat e mbarështimit të kafshëve që përpunojnë vetëm plehun e stallës që prodhojnë vetë dhe e kthejnë në pleh organik dhe/ose biogaz për përdorim vetjak në vetë fermën e tyre, të cilit mund t'i shtohen përzierje ose mbetje të vetë stallës, të aparatit tretës të kafshëve të vetë fermës, produktet derivate të trajtimit ose të transformimit të produkteve shtazore të cilat përpunohen në një impiant përpunimi e lidhur me fermën dhe janë në pronësi të pronarit të fermës të

- tilla si: qumështi, produkte me bazë qumështi, kulloshtre, produkte me bazë kulloshtre, vezë, produkte me bazë vezët dhe nënprodukte shtazore sipas përshkrimeve të nenit 10, shkronja f) të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
4. Përfshihen nga kërkesat për licencim landfillet dhe impiantet e djegies ose të djegies për prodhimin e enegjisë që janë të licencuara për eliminimin e mbetjeve urbane, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi
  5. Operatorët e biznesit që përpunojnë nënprodukte me origjinë shtazore nuk fillojnë të operojnë në fushën e zgjedhur nëse nuk janë të licencuar sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni. Përpunimi i nënprodukteve shtazore bëhet vetëm nga operatorë të licencuar.
    - a) Në rast të ndërprerjes vullnetare të aktivitetit të licencuar për përpunimin e nënprodukteve shtazore operatorët njoftojnë me shkrim Autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij vendimi. Rifillimi i aktivitetit të operatorit të përpunimit të nënprodukteve shtazore, i ndërprerë në formë vullnetare nga vetë ai behet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Autoriteteve kompetente të përcaktuar në nenin 3 të këtij.
    - b) Nëse vendimi i ndërprerjes së aktivitetit është urdhëruar nga njëri prej Autoriteteve kompetente të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të këtij vendimi, si rezultat i kontrolleve zyrtare të kryera nga ai, rifillimi i aktivitetit bëhet vetëm pasi të jetë autorizuar nga Autoriteti kompetent që ka urdhëruar ndërprerjen e aktivitetit.
    - c) Pas licencimit operatori njofton autoritetet kompetente të përcaktuara në këtë pikë për çdo fillim aktiviteti, rifillim aktiviteti, mbyllje aktiviteti, pezullim aktiviteti, ndryshim emërtimi, ndryshim prodhimi, ndërprerje vullnetare të aktivitetit duke përdorur formularin sipas shtojcës së tretë formulari II të këtij vendimi.
  6. Në kërkesën për licencim ose për autorizim, për përpunimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate si dhe trajtimit të mbetjeve të tyre, sipas përshkrimeve të shtojcës së parë dhe të shtojcës së dytë, të këtij vendimi, operatori deklaron që aktiviteti plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në shtojca, në fushën në të cilën ai do të ushtrojë aktivitetin. Kërkesa shoqërohet nga:
    - a. një relacion teknik, i cili hartohet mbi bazën e kërkesave të shtojcës së dytë, të këtij vendimi, përsa i përket tipit të impiantit ose stabilimentit dhe metodës së përpunimit. Relacioni përshkruan edhe mënyrën e furnizimit me ujë, mënyrën e pastrimit dhe eliminimit të ujrave të përdorur në procesin teknologjik, karakteristikat e impianteve të pastrimit të ujit, mënyrën e eliminimit të mbetjeve të lengshme dhe të ngurta që prodhon vetë impianti ose stabilimenti gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij;
    - b. një planimetri të impiantit ose stabilimentit në shkallën 1:100. Planimetria nuk është e nevojshme nëse biznesi zhvillon veprimtari vetëm të transportit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate.
    - c. Formulari sipas shtojcës së tretë, formulari III i këtij vendimi.
  7. Pas kërkesës për licencim, Autoritetet kompetente sipas fushës së kompetencës kryejnë nga një kontroll zyrtar në vend. Autoritetet kompetente lëshojnë një dokument, në të cilën vërtetojnë që impianti ose stabilimenti është në përputhje me kërkesat ligjore të fushës së tij dhe jep miratimin ose përcakton një kohë të caktuar për plotësimin e kërkesave të ligjit, ose refuzon miratimin sipas përshkrimeve të kapitullit III, të aneksit XVI, të shtojcës së dytë të

- këtij vendimi. Në përfundim të afatit të përcaktuar për plotësimin e kushteve të vendosura, Autoriteti kompetent kryen një kontroll të dytë dhe në konkluzion të rezultateve, vendos për miratimin ose refuzimin përfundimtar të aktivitetit. Kontrolli zyrtar kryhet në përputhje me përshkrimet e aneksit XVI të shtojcës së dytë të këtij vendimi.
8. Lista e operatorëve të licencuar për përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë e cila e përditëson atë. Lista merrret nga Qendra Kombëtare e Licensimit.
  9. Në rast se operatori bën ndryshime të strukturës të impiantit ose stabilimentit dhe/ose e kushteve të licencës, njofton menjëherë Autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij vendimi dhe fillon procedurat e ndryshimit të licencës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të licencave.
  10. Licenca jepet vetëm pasi Autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 neni 3 i këtij vendimi kanë dhënë miratimin, pasi kryejnë kontrollet zyrtare në përputhje me kërkesat e aneksit XVI të shtojcës së dytë.
  11. Licenca e ushtrimit të aktivitetit përcakton:
    - a. metodën e trajtimit të nënprodukteve nga 1 në 7, sipas përshkrimeve të aneksit IV kapitulli III të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
    - b. tipin e stabilimentit ose të impiantit, sipas nenit 24 të shtojcës së parë.
    - c. aktivitetin e ushtruar dhe produkti përfundimtar sipas shtojcës së tretë, formulari III të këtij vendimi.

ç) kategorinë e materialit të trajtuar, të përshkruar në nenet 8, 9 ose 10 të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
  12. Operatorët e biznesit që prodhojnë, transportojnë, përpunojnë, fusin në treg, shpërndajnë, magazinojnë, përdorin dhe asgjësojnë nënprodukte shtazore dhe produkte derivate si dhe mbetje me origjinë shtazore pajisen me licencë mjedisore sipas kërkesave të ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe të legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.
  13. Operatorët e biznesit që prodhojnë, transportojnë, përpunojnë, fusin në treg, shpërndajnë, magazinojnë, përdorin dhe asgjësojnë nënprodukte shtazore dhe produkte derivate si dhe mbetje me origjinë shtazore trajtonë njëkohësisht materiale të kategorive sipas neneve 8, 9 ose 10 të shtojcës së parë të këtij vendimi, në kërkesën për licencë përshkruajnë mënyrën e ndarjes së plotë të impianteve të përpunimit sipas secilës kategori.
  14. Në rast se operatori nuk plotëson kërkesat sipas neneve 8, 9 dhe 10 të shtojcës së parë të këtij vendimi, i hiqet licenca nga autoriteti kompetent dhe nuk pajiset me licencë të re deri kur operatori të kryejë ndarjen fizike të sigurtë të proceseve të përpunimit të nënprodukteve të përcaktuara në nenet 8, 9, dhe 10 të shtojcës së parë, të këtij vendimi.

#### *Neni 6*

#### *Qëndrat e grumbullimit, grumbullimi dhe ruajtja e nënprodukteve shtazore*

1. Nënproduktet me origjinë shtazore të kategorisë 1, 2 dhe 3 grumbullohen çdo ditë nga vendet në të cilat janë prodhuar, ato ruhen dhe magazinohen në kontejnerë, në mjedise të mbyllura me temperaturë 4 gradë dhe transportohen me kontejnerë në temperaturën 4 deri në 7 gradë.

2. Kontejnerët janë qartësisht të identifikueshëm në bazë të tipologjisë së materialeve për të cilët janë caktuar. Ata kanë në paretet e jashtme të tyre një shirit të ngjitur ose pikturuar më i gjatë se 15 cm dhe i gjerë më shumë se 15 cm deri në të gjithë gjerësinë e vetë faqes së kontejnerit. Ngjyra të shiritave janë:
  - **E ZEZË**, materialet e kategorisë 1, (#000000; rgb (0, 0, 0); hsl (0, 0%, 0%));
  - **E VERDHË**, materialet e kategorisë 2, (#ffff00; rgb (255, 255, 0); hsl(60, 100%, 50%));
  - **E GJELBËR**, materialet e kategorisë 3, (#009933; rgb (0, 153, 51); hsl (140,100%, 30%)).
3. Mbledhja e karkasave të kafshëve të ngordhur në fermën e mbarështimit kryhet menjëherë sapo të jetë e mundur, por jo me vonë se 12 orë nga ngordhja. Gjetjet shënohen nga operatori që grumbullon karkasat, në një regjistër të shkruar i cili përmban: datën, orën, sasinë dhe llojin e kafshës dhe kategorinë e karkasave të gjetura. Ky regjistër ruhet për dy vjet nga data 31 dhjetor e vitit të mbajtjes.
4. Qëndrat e grumbullimit licencohen sipas kërkesave të këtij vendimi. Ato përmbushin të gjitha kërkesat e këtij vendimi. Qëndrat e grumbullimit lidhin kontrata me prodhues, përpunues, transportues dhe tregtarë të nënprodukteve me origjinë shtazore si dhe me klinika veterinare.
5. Qëndrat e grumbullimit që janë të ndërtuara me kapital privat lidhin kontrata me të gjithë ata subjekte që bëjnë kërkesë si dhe me individë private.
6. Bashkitë ndërtojnë qendra të grumbullimit vetëm për kadavrat e kafshëve të ngordhura. Kadavrat që janë të kafshëve të shoqërimit në pronësi të qytetarëve privatë ose kafshët e shoqërimit pa pronar si dhe kafshët e egra të ngordhura ose të eliminura nga shërbimi veterinar në kuadrin e luftës për çrrënjosjen e një sëmundje të kafshëve të egra ose e uljes së numrit të tyre sipas programeve të miratuara dhe aktiviteteve të tjera veterinare.
7. Tarifat e grumbullimit të kafshëve të shoqërimit me pronar përcaktohen nga legjislacioni mbi Bashkitë. Ndërsa për kadavrat e kafshëve të rrugës dhe kadavrat e kafshëve të egra të eliminuara nga shërbimi veterinar në territorin e Bashkisë përkatëse shpenzimet e grumbullimit dhe shpenzimet e tjera caktohen nga buxheti i vetë Bashkisë. Bashkitë ndërtojnë qëndrat e grumbullimit të kadavrave të kafshëve jo me vonë se data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Qëndrat e grumbullimit lidhin kontrata me bizneset e përpunimit ose eliminimit të nënprodukteve shtazore.
9. Temperatura e ruajtjes në qëndrat e grumbullimit të nënprodukteve me origjinë shtazore është jo më lartë se 4 °C.

## *Neni 7*

### *Transporti i nënprodukteve me origjinë shtazore*

Transporti i nënprodukteve me origjinë shtazore bëhet sipas kërkesave të aneksit VIII të shtojcës së dytë dhe në veçanti:

1. Transporti i nënprodukteve me origjinë shtazore bëhet në ambalazhe një përdorimësh, të cilat nuk mundësojnë rrjedhjen e lëngjeve, ambalazhet janë të reja dhe që mund të mbyllen ose në kontejnerë që ripërdoren dhe që nuk krijojnë mundësinë e rrjedhjes së lëngjeve.
2. Pas dorëzimit të nënprodukteve shtazore në impiantin ose stabilimentin e destinacionit ambalazhet eliminohen sipas kërkesave të ligjit dhe kontejnerët e ripërdorshëm lahen dhe dezinfektohen brenda impiantit ose stabilimentit që kanë marrë në dorëzim nënproduktet shtazore. Data dhe ora e kryerjes së operacioneve të pastrimit dhe dezinfektimit shënohet nga operatori i impiantit ose stabilimentit që ka kryer pastrimin dhe dezinfektimin në dokumentet

e transportit të transportuesit dhe regjistrohet në regjistrin e larjes dhe dezinfektimit të mjeteve të transportit.

3. Regjistri i larjes dhe dezinfektimit të mjeteve të transportit përmban:
  - a) datën dhe orën e kryerjes së operacionit;
  - b) numrin e dokumentit shoqërues që ka sjellë mallin.
  - c) dërguesin e mallit
  - d) targën e mjetit të transportit, dhe
  - e) emërtimin e transportuesit kur ai është i ndryshëm nga dërguesi.
4. Nëse operacionet e larjes dhe dezinfektimit të mjeteve të transportit nuk kryhen nga operatori sipas pikës 2 të këtij neni, ai lidh një kontratë ligjore me një operator të specializuar që kryen larjen dhe dezinfektimin e mjetit të transportit e cila kryhet jo më vonë sesa mjeti të marrë një ngarkesë të re dhe sidoqoftë jo më vonë se të krijohen mundësitë e ndotjes së ambientit me aroma të këqija që vijnë nga mjeti i transportit të papastër. Operatori i specializuar mban regjistrin e përshkruar në pikën 3 dhe njofton për çdo operacion pastrimi dhe dezinfektimi operatorin e kontraktuar.
5. Më qëllim që të parandalohet ndotja e kryqëzuar në mes kategorive të nënprodukteve me origjinë shtazore, automjetet caktohen për transportin e vetëm të një kategorie nënproduktesh shtazore të përcaktuar nga shtojca e parë e këtij vendimi. Kur ripërdoren ato markohen me shirita të ngjyrosur sipas pikës 2 të nenit 6 të këtij vendimi. Dimensionet e shiritave në këtë rast kanë përmasat më të mëdha se 50 cm x 35 cm dhe gërmat jo më të vogla në lartësi se 5 cm;
6. Kur transportohen më shumë se një parti malli në një mjet transporti dhe secila parti i përket kategorive të ndryshme dhe partite nuk mund të ndahen në kontejnerë të veçantë, atëherë të gjitha kategoritë pavarësisht se cilës kategori i përkasin trajtohen sikur të ishin të kategorisë më të rrezikshme sipas neneve 8, 9 dhe 10 të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
7. Nëse krijohet nevoja për transportin në një mjet transporti të më shumë partive të mallit që janë nënprodukte shtazore i përkasin kategorive të ndryshme sipas kërkesave të neneve 8, 9, dhe 10 të shtojcës së parë të këtij vendimi, Autoriteti kompetent sipas pikës 1 gërma b, neni 3 i këtij vendimi, lejon transportin me kusht që materialet të transportohen në kontejnerë të ndarë, hermetikisht të mbyllur dhe të markuar në mënyrë të dallueshme sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 6 të këtij vendimi.
8. Transporti i nënprodukteve shtazore të destinuara për prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimin, kryhet në temperaturë të kontrolluar siç parashikohet nga aneksi VIII, kapitulli I, seksioni 2 i shtojcës së dytë të këtij vendimi, me përjashtim të rastit kur do t'ju nënshtrohen transformimit në vendin ku janë mbledhur brenda 24 orëve nga prodhimi ose magazinimi në të ftohtë.
9. Mjekët veterinarë që ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në përputhje me ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, autorizojnë transportin e trupave të kafshëve të ngordhura, të madhësive të vogla ose të mesme, si dhe nënprodukte të tjera shtazore, që do të dërgohen në institucionet e kërkimit shkencor, laboratorët veterinarë, fakultetin e veterinarisë ose për qëllime të tjera didaktike ose diagnostike. Për këtë përdoren kontejnerë të rinj një përdorimesh, të cilët nuk bëjnë të mundur rrjedhjen e lëngjeve, të identifikuar sipas kërkesave të aneksit VIII, kapitulli II i shtojcës së dytë, të këtij vendimi. Kontejneri i cili mban karakasën ose nënproduktin shtazor mbyllet



hermetikisht dhe mund të dërgohet në destinacionet e përshkruar më sipër edhe duke përdorur edhe një mjet vetjak transporti.

10. Transporti i plehut të stallës dhe i likuideve të stallës, kur përdoret për qëllime agronomike, në mes dy pikave të vendosura në të njëjtën fermë ose në mes dy fermave të vendosura në të njëjtin rajon administrativ, nuk është subjekt i licencimit sipas kërkesave të shtojcës së parë, të këtij vendimi. Malli shoqërohet vetëm nga një dokument sanitar sipas shtojcës së tretë, formulari I të këtij vendimi.
11. Plehu i stallës, përfshirë likuidet e stallës mbliidhen dhe transportohen duke përdorur:
  - a) mjete transporti të mbuluar, të cilët nuk rrjedhin lëngje, për transportin e plehut të stallës të lëngshëm;
  - b) mjete transporti të përshtatshme që të parandalojnë rrjedhjen e materialit në formë të ngurtë i cili nuk përmban pjesë të lëngshme;
12. Duke respektuar kërkesat ligjore të transportit (identifikimi i nënprodukteve, regjistrimi i partive të mallit, dokumentet tregtarë) është i lejuar transporti i nënprodukteve me origjinë shtazore duke përdorur mjete transporti ose kontejnerë që përdoren për transportin e produkteve për konsum nga njerëzit në rastet që vijojnë:
  - a) nënprodukte sipas përshkrimeve të nenit 10 të shtojcës së parë, të këtij vendimi gërma f) (produkte që nuk janë më të destinuara për konsum nga njerëzit për arsye tregtare, probleme të prodhimit ose për defekte të tjera) përfshirë produktet e hequra nga tregu për shkaqe të ndryshme me kusht që të mos kenë pësuar ndryshime të karakteristikave organo-leptike të pa pranueshme (produkte që ka filluar të humbasin karakteristikat organo-leptike) në mënyrë të tillë që të përbëjnë një rrezik për shëndetin publik ose të kafshëve dhe të parandalohet çdo mundësi e ndotjes së kryqëzuar.
  - b) nënproduktet sipas përshkrimeve të nenit 10 të shtojcës së parë, të këtij vendimi gërmat a), e), i), dhe j) të destinuara vetëm për prodhimin e ushqimit të kafshëve të shoqërimin ose produkteve derivate sipas përshkrimeve të nenit 33, me kusht që të dorëzohen direkt në impiantin e përpunimit të nënprodukteve shtazore, në kushtet që vijojnë:
    - i) të mos transportohen me mjete transporti rifuxho;
    - ii) të mos transportohen njëkohësisht me produktet ushqimore për konsum nga njerëzit;
    - iii) gjatë transportit të ruajnë karakteristikat organo-leptike që ishin të përshtatshme për konsum nga njerëzit;
    - iv) të ambalazhuara në formë të përshtatshme.
    - v) qumështi ose hirra e destinuar për ushqimin e kafshëve të mbarështuara, në ndryshim nga aneksi X, kapitulli II, seksioni IV, pjesa II e shtojcës së dytë, të këtij vendimi, transportohet direkt në fermat blegtorale që i përdorin, nëpërmjet cisternave të caktuara për transportin që qumështit që konsumohet për njerëzit, me kusht që qumështi ose hirra të ruajnë të pa ndryshuara karakteristikat organo-leptike dhe mjete të transportit të identifikohet në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 6 të këtij vendimi.

### ***Neni 8***

#### ***Dokumenti i shoqërimit dhe certifikatat e nënprodukteve me origjinë shtazore***

1. Gjatë transportit në territorin kombëtar, nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate shoqërohen me një dokument shoqërimi të hartuar sipas modelit në shtojcën e tretë formulari I të këtij vendimi.
2. Dokumenti hartohet në tri kopje. Originali shoqëron partinë e mallit deri në destinacionin përfundimtar. Prodhuesi dhe transportuesi ruajnë nga një kopje.
3. Dokumenti i shoqërimit ruhet për dy vite nga data 31 dhjetor e vitit në të cilin është lëshuar. Ky dokument është i vlefshëm vetëm për lëvizjen e nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate në territorin kombëtar.
4. Dokumenti nuk është i nevojshëm për transportin e nënprodukteve që vijojnë:
  - a) spostimin e plehut të stallës në mes dy fermave që gjenden në të njëjtin rajon administrativ.
  - b) ushqimet e përbëra për kafshë, kur ato janë të etiketuara në bazë të legjislacionit për etiketimin e tyre.
5. Për nënproduktet me origjinë shtazore të destinuara për prodhimin e ushqimeve për kafshë ose ushqime të pa përpunuara për kafshët e shoqërimit i bashkëlidhen dhe informacionet e detyrueshme sipas legjislacionit të etiketimit të ushqimit për kafshë.
6. Dokumenti për transportin e hirrës përmban edhe trajtimin ndaj të cilit i është nënshtruar.
7. Gjatë transportit, nënproduktet shoqërohen me certifikate sanitare të hartuara sipas modeleve të aneksit XIV të shtojcës së dytë 2 të këtij vendimi.
8. Çertifikatat lëshohen nga autoriteti kompetent sipas pikës 1 gërma b të nenit 3 të këtij vendimi.

### ***Neni 9***

#### ***Regjistri, gjurmueshmëria***

1. Operatorët që prodhojnë, dërgojnë, transportojnë, magazinojnë, tregtojnë apo asgjësojnë nënprodukte me origjinë shtazore mbajnë regjistra sipas kërkesave të nenit 22 të shtojcës së parë të këtij vendimi, dokumentet përkatës tregtare dhe certifikatat sanitare.
2. Plotësimi i regjistrit kryhet menjëherë sapo procesi të përfundojë.
3. Informacionet minimale që përmban regjistri janë të përshkruara në aneksin VIII, kapitulli IV, seksioni I, të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
4. Operatorët sipas pikës 1 i japin, i paraqesin ose i dërgojnë regjistrat dhe të gjitha dokumentet e tjerë autoriteteve kompetentë me kërkesën e tyre.
5. Regjistrat krijohen në datë 1 janar të çdo viti dhe mbyllen me 31 dhjetor të çdo viti. Regjistrat e krijuar brenda një viti kanë një numër progresiv. Regjistrat e një viti ruhen për pesë vite nga data e mbylljes së regjistrit të fundit të një viti.

### ***Neni 10***

#### ***Autokontrolli i sigurisë, analiza e rriskut, krijimi dhe monitorimi i Pikave Kritike të Kontrollit (HACCP)***

1. Operatorët gjatë prodhimit, përpunimit, magazinimit, transportit, tregtimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate, mbështetur në parimet e analizës së kontrollit të rrezikut sipas ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin" dhe sipas përshkrimeve të neneve 28 dhe 29 të shtojcës së parë të këtij vendimi, me ndihmën e operatoreve të specializuar në këtë fushë,

hartojnë, mbajnë dhe zbatojnë planet e masave përsa i përket autokontrollit të sigurisë, analizës së rrishtit dhe pikave kritike të kontrollit, monitorimit të pikave të kontrollit dhe masave për korrigjimin e tyre. Ato i japin, i paraqesin ose i dërgojnë Autoritetit kompetent planin e masave të autokontrollit dhe të gjithë dokumentet që i përkasim zbatimit dhe monitorimit të pikave kritike të kontrollit.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij neni ngarkohet Autoriteti kompetent i përcaktuar në pikën 1c të nenit 3 të këtij vendimi.

### ***Neni 11***

#### ***Kategorizimi i nënprodukteve me origjinë shtazore***

Materialet kategorizohen në procesin e ushtrimit të aktivitetit veterinar dhe gjatë prodhimit dhe përpunimit të produkteve ushqimore. Kategorizimi kryhet nga:

- a) Mjekët veterinarë gjatë ushtrimit e funksionit të tyre sipas ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- b) Inspektorët e kontrollit të produkteve me origjinë shtazore gjatë ushtrimit të funksionit të tyre sipas ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar;
- c) Nga operatorët e biznesit ushqimor gjatë procesit të prodhimit, përpunimit, magazinimit, transportit dhe tregtimit të produkteve ushqimore me prejardhje shtazore.

### **Neni 12**

#### **Mënyra e asgjësimit ose eliminimit të mbetjeve me prejardhje shtazore që rrjedhin nga materialet e kategorive 1, 2, dhe 3**

Asgjësimi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate të kategorisë 1, kategorisë 2 dhe kategorisë 3, kur ato deklarohen dhe klasifikohen si mbetje ose mbeturina me origjinë shtazore sipas pikës 14, neni 3 i këtij vendimi, kryhet në bazë të mënyrave të parashikuara nga nenet 12, 13 dhe 14 të shtojcës së parë të këtij vendimi duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbetjet. Kur janë të klasifikuar si të tilla, ato asgjësohen në:

1. Impiante të djegies ose të djegies për prodhimin e energjisë të licencuar me ose pa trajtim paraprak ose sterilizim nën presion dhe markim të përhershëm, sipas kërkesave të shkronjës a), të nenit 6, të shtojcës së dytë të këtij vendimi;
2. Në një landfill të licencuar, pas kryerjes së sterilizimit nën presion dhe markimit të përhershëm të materialit, për materialet e kategorisë 1 dhe për materialet e kategorisë 2, me përjashtim të atyre të përshkruar në nenin 8, shkronja a), pikat i) dhe ii), të shtojcës së parë të këtij vendimi, që janë trupa të plotë dhe të gjitha pjesët e tyre, përfshirë lëkurat për të cilat dyshohen që janë të prekura ose që rrjedhin nga kafshët e prekura me TSE.
3. Nënproduktet e përshkruar në nenin 8, shkronja a), pikat i) dhe ii), të shtojcës së parë të këtij vendimi (trupa të plotë dhe të gjitha pjesët e tyre, përfshirë lëkurat për të cilat dyshohen që janë të prekura ose që rrjedhin nga kafshët e prekura me TSE), digjen në impiante të djegies ose groposen në një landfill të autorizuar pas djegies së pjesshme të tyre.
4. Në një landfill të licencuar, kur bëhet fjalë për materiale të kategorisë 1 të përshkruara në nenin 8, shkronja c) të shtojcës së parë, të këtij vendimi, sipas kërkesave të nenit 7, shkronja a) të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.

5. Në një landfill të licencuar, kur bëhet fjalë për materialet e kategorisë 1, neni 8 shkronja f) të shtojcës së parë, të këtij vendimi, pas një trajtimi paraprak.
6. Në një landfill të licencuar kur bëhet fjalë për materiale të kategorisë 3, pas një trajtimi paraprak në një impiant të licencuar sipas kërkesave të nenit 24 të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
7. Në një landfill të licencuar, kur bëhet fjalë për materiale të kategorisë 3, të përshkruara në nenin 10, shkronja g) të shtojcës së parë, të këtij vendimi, në kushtet e përcaktuara nga neni 7, shkronja b), nën shkronja ii) të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
8. Kadavrat e kafshëve të ngordhura nga sëmundjet:
  - a) antrax digjen në një impiant të licensuar ose groposen në vend pas djegies së plotë ose të pjesshme ose pasi të jetë hedhur gelqere e pashur (CaO) në prani të veterinarit zyrtar.
  - b) tuberkulozi, dermatoza nodulare, gjuha blu, pseudopesti, influenza aviare digjen në impiant të licensuar ose groposen në një landfill të licensuar.
  - c) djegja ose groposja e trupave të kafshëve të ngordhura nga sëmundje të tjera vendoset nga veterinarit zyrtar.
  - d) në përjashtim të pikave a), b), dhe c) në zbatim të nenit 19 pika 1 gërma b, pika 1 gërma c, pika 1 gërma d dhe pika 1 gërma e të shtojcës së parë, eliminimi bëhet nëpërmjet djegies, djedies dhe groposjes ose groposjes në vend në zonat e izoluara të veshitura për tu arritur ose me dendësi popullore kafshësh të ulët.
  - e) zonat e izoluara ose me popullsi kafshësh të ulet sipas nenit 19 pika 1, përcaktohen nga Autoriteti kompetent i përcaktuar në nenin 3 pika 3 gërma b e këtij vendimi mbështetur në kërkesat e aneksit VI kapitulli III, seksioni 2 brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, mbështetur në ligjin Nr.115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
9. Në impiantet e djegies ose të djegies për prodhimin e energjisë sipas përshkrimeve të nenit 6 nën paragrafi i parë shkronja b) të shtojcës së dytë, të këtij vendimi bëhet asgjësimi:
  - a) i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që i përkasin kategorisë 1, kategorisë 2, dhe kategorisë 3, dhe
  - b) i të gjitha nënprodukteve të tjera, të përcaktuara në nenet 12, 13, 14 të shtojcës së parë të këtij vendimi
10. Nënproduktet shtazore të krijuara nga gjahtarët gjatë ushtrimit të ligjshëm të guetisë eliminohen direkt në vendin e guetisë nëpërmjet groposjes. Gropat janë të thella në vartësi të masës së groposur dhe nuk bëjnë të mundur nxjerrjen e nënprodukteve të groposura nga kafshët e egra.
11. Eliminimi i nënprodukteve të peshkut të prodhuara në anijet e peshkimit të cilat bëjnë përpunimin e peshkut në bord gjatë lundrimit bëhet duke i hedhur në det, me përjashtim të atyre nënprodukteve të cilat rezultojnë të infektuara ose infestuar nga sëmundje që tranmetohen tek njerezit ose kafshët.
12. Eliminimi i nënprodukteve të peshkut të prodhuara në anijet e peshkimit të cilat bëjnë përpunimin e peshkut në bord gjatë lundrimit të cilat rezultojnë të infektuara ose infestuar nga sëmundje që tranmetohen tek njerezit ose kafshët, bëhet:

- a) sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni, në impiante të djegies të ndërtuara në bordin e anijes ose në tokë; ose
  - b) në një landfill të autorizuar sipas pikës 2 të këtij neni.
13. Gropsja e nënprodukteve shtazore që rrjedhin nga përpunimi, magazinimi, transporti, konfiskimet si rezultat i kontrolleve zyrtare, veprimtaritë mjeksore veterinare bëhet vetëm në rastet e pamundësisë për ti djegur ato. Gropasja kërkohet nga prodhuesi ose pronari i tyre tek vetinari zyrtar dhe autorizohet nga veterinari zyrtar përgjegjës për zonën administrative ku ato prodhohen pasi ato janë deklaruar, nga ai, si mbeturina me origjinë shtazore, përfshirë dhe rastin e germës e) të pikës 8 të këtij neni. Kërkesa dhe autorizimi bëhet me shkrim sipas formularit që figuron në shtojcën e trete, formulari IV të këtij vendimi.
14. Në ndryshim nga përcaktimi i pikës 2 të nenit 15 të këtij vendimi, Veterinari zyrtar, kur nuk ekziston mundësia e trajtimit si nënprodukte me origjinë shtazore, autorizon groposjen në vënd të vetëm të kadavrave të kafshëve të fermave të cilat nuk kanë më tepër se 10 “njësi gjedhë”. Terreni ku bëhet groupsja duhet të jetë në pronësi të pronarit të kafshëve që groposen ose në një terren që nuk është pronë e pronarit të kafshës së ngordhur i cili lidh një kontratë me pronarin e tokës ku do të bëhet groupsja. Kërkesa dhe autorizimi bëhet me shkrim sipas formularit që figuron në shtojcën e trete, formulari IV të këtij vendimi.
15. Me kryerjen e groposjes sipas pikës 14 të këtij neni pronari i kafshës mban dhe ruan për tre vjet dokumentin mbi pronësinë e tokës, kërkesën dhe miratimin e sajë nga veterinari zyrtar dhe certifikatën veterinare e cila përcakton diagnozën dhe shkakun e ngordhjes.
16. Të gjitha rastet gropat duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
- a) Gropa nuk duhet të hapet në kushte mjedisore e cilat nuk përbëjnë rrezik për ndotjen e ujrave sipërfaqësore, të ujrave nëntokësore dhe të terrenit.
  - b) Thellësia e gropës është e tillë që të lejoje mbi dy metra dhe (tokë) sipër masës së groposur deri në planin e sipërfaqes së tokës. Vetëm për kafshët e ngordhura nga Plasja (Anthrax) thellësia e gropës është e tillë që të lejoje mbi tre metra dhe (tokë) sipër kadavrës (kadavrave) së groposur deri në planin e sipërfaqes së tokës.
  - c) Në fundin e gropës hidhet gëlqere e pashuar (CaO) ose një substance tjetër me efekt të ngjashëm në trashësi prej 20 cm në të gjithë sipërfaqen fundore të gropës. Në rastin e groposjes së kadavrave me plasje trashësia e gëlqeres së pashuar që hidhet në fundin e gropës është 30 cm. Sipërfaqja e fundit të gropës është 0.5-0.7 m<sup>2</sup> për çdo ton masë të groposur dhe ka pjerrësi 1-2 %.
  - d) Mbi masën e mbeturinave me origjinë shtazore, kadavren (kadavrat) e groposur dhe në faqet anësore të gropës hidhet gëlqere e pashuar (CaO) jo më pak se 2.5% të masës ose kadavrës që groposet.
  - e) Në tokat e rënda, moçalore, argjilore dheu mbulues mund të përzihet me rërë ose material tjetër te ngjashëm me rërën deri në masë 10%.
  - f) Kur groupsoset në stinë e shirave grupa mbulohet për një periudhë deri në tre javë me celofan (plasmas) duke krijuar mundësinë e largimit të gazit që çlirohet nga masa e groupsur.
  - g) Vendi i groupsjes duhet të jetë të paktën 500 m nga vendi i burime të marrjes apo furnizimit me ujë sipërfaqësor ose/dhe nëntoksor të destinuar për vaditjen ose pirjen

e ujit nga kafshët, 300 m nga bregu i lumenjve, liqeneve, përrenjëve ose kolektorëve të mëdhenj të ujrave të kullimit dhe dhe jo më pak se 50 m nga kanale të rrjedhjes së ujrave sipërfaqësore.

- h) I njëti vend i groposjes nuk mund të përdoret më parë se të kenë kaluar të paktën 2.5 vite.
  - i) Fundi i gropës është të paktën 5 m mbi rrugët e rrjedhjeve nëntokesore të njohura.
  - j) Groposja nuk bëhet në:
    - Zona të cilat janë brenda zonave të klasifikuara me rezikshmeri hidrologjike dhe gjeologjike të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.
    - Në zona në cilat ndodhen vend burimet e ujit për konsum nga njerëzit.
    - Në zona të cilat njihen si zona që kanë erozion të lartë.
    - Në afërsi të gropave karsike, formacioneve me rëndësi natyre, gjeologjike dhe turistike.
    - Në zona të cilat janë subjekt i formave të ndryshme të aktivitetit vullkanik dhe hidro-termale.
17. Landfillet të cilat janë pronë e shtetit ose janë shoqëri që në përbërje kanë kapital shtetëror pranojnë mbeturina me origjinë shtazore dhe i propozin ato në përputhje me kërkesat e këtij vendimi. Landfillet lidhin kontrata me operatorët që prodhojnë, përpunojnë, magazinojnë, tregtojnë, dhe mbledhin nënprodukte me origjinë shtazore. Landfillet e licencuara sipas legjislacionit përkatës për landfillet përcaktojnë një zonë vetëm për groposjen e mbeturinave me origjinë shtazore jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Përmasat e zonës janë në përputhje me sasitë e mundshme (të pritshme) të mbeturinave me origjinë shtazore që mund të kërkojnë të propozohen. Tarifat për groposjen e mbeturinave me origjinë shtazore përcaktohen sipas marrëveshjeve kontaktuale.
18. Landfillet të cilat janë të ndërtuara plotësisht me investime privatë pranojnë dhe propozin mbeturina me origjinë shtazore në bazë të marrëveshjeve dypalëshe. Këto landfille licencohen ndërtohen dhe respektojnë kërkesat e këtij vendimi. Ato përcaktojnë një zonë të veçantë për groposjen e mbeturinave me origjinë shtazore. Tarifat e groposjes vendosen me marrëveshje dypalëshe.
19. Inceneritorët të cilët janë në pronësi të shtetit ose janë shoqëri me kapital shtetëror pajisen me impiante incenerimi të mbetjeve me origjinë shtazore jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Inceneritorët për djegien ose djegien për prodhimin e energjisë plotësojnë kërkesat e këtij vendimi. Inceneritorët lidhin kontrata me operatorët që prodhojnë, përpunojnë, magazinojnë, tregtojnë, dhe mbledhin nënprodukte me origjinë shtazore. Tarifat për djegien e mbeturinave me origjinë shtazore përcaktohen sipas marrëveshjeve kontaktuale.
20. Inceneritorët të cilët janë kapital privat lidhin kontrata me operatorët që prodhojnë, përpunojnë, magazinojnë, tregtojnë, dhe mbledhin nënprodukte me origjinë shtazore. Ato licencohen dhe plotësojnë kërkesat e këtij vendimi. Prodhuesit e mbeturinave me origjinë shtazore mund të pajisen me inceneritorë për djegien e mbeturinave që prodhojnë vetë ato. Në këte rast licencohen dhe për djegien e mbeturinave. Ato mund të djegin mbeturina me origjinë shtazore të prodhuara nga operatorë të tjerë. Në këte rast rruga e futjes së mbeturinave për tek inceneritori duhet të jetë e caktuar dhe nuk krijon mundësi të kontaktit

fizik me pjesën tjetër të biznesit. Tarifat e djegies së mbeturinave me origjinë shtazore përcaktohen me merrëvehje dypalëshe.

### **Neni 13**

#### **Lëkurat dhe përpunimi i tyre**

1. Lëkurat e kafshëve të therura në thertore janë subjekt i shtojcës së parë të këtij vendimi kur si rezultat i kontrollit veterinar, pas therjes, rezultojnë si të pa përshtatshme për prodhimin e xhelatinës ose kolagenit të destinuar si ushqim për njerëzit.
2. Lëkurat e klasifikuara si nënprodukt shtazor:
  - a) regjistrohen në regjistrin e nënprodukteve shtazore;
  - b) shoqërohen nga një dokument tregtar transporti sipas kërkesave të këtij vendimi;
  - c) lëkurat mbajnë numrin e matrikullit të kafshës së cilës i përkasin. Thertorja që ka kryer therjen bën dhe identifikimin e lëkurës i cili përmban të ngjitur, të lidhur të shkruar në mënyre që nuk fshihet dhe numrin e matrikullit të kafshës.
  - d) Thertorja regjistron lëkurët për ta garantuar gjurmueshmërinë e atyre që janë të përshtatshme për prodhimin e xhelatinës dhe kolagenit për konsum nga njerëzit dhe të atyre që nuk janë të përshtatshme.
  - e) Lejohet transporti njëkohësisht i lëkurëve që janë të përshtatshme për prodhimin e xhelatinës dhe kolagenit dhe të atyre që janë të klasifikuara si të kategorisë 3, me kusht që:
    - i) Lëkurët të transportohen në kontejnerë të ndryshëm;
    - ii) Lëkurët të jenë të shoqëruara me dokumentet përkatës të ndryshëm.
  - f) Magazinat e grumbullimit të përkohshëm të lëkurëve të kategorisë 3, janë subjekt i licencimit sipas kërkesave të nenit 24, paragrafi i parë shkronja h) ose shkronja i) të shtojcës së parë, të këtij vendimi;
  - g) Mund të futen në treg pa kufizime të mëtejshme lëkuret që plotësojnë kërkesat e pikës C.2 të kapitullit V të aneksit XIII të shtojcës së dytë të këtij vendimi sipas përshkrimeve të nenit 5, paragrafi 2 të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
3. Prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe trajtimi i lëkurës përfshihet në veprimtaritë “instalimet për trajtimin me regjije dhe prodhimin e lëkurës” sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe të mbetjeve.

### **Neni 14**

#### **Fertilizantët organike dhe plehu organik**

Produkte derivate që rrjedhin nga pjesë e materialeve që i përkasin kategorive 2 dhe 3 dhe proteinave shtazore të transformuara, me përjashtim të plehut të stallës, që nuk janë të destinuar për prodhimin e biogazit mund të përdoren si fertilizantë organike ose pleh organik me kusht që të jenë të destinuar për t'u përpunuar në impiante të miratuar sipas kërkesave të nenit 24, paragrafi 1, shkronja f) të shtojcës së parë, të këtij vendimi. Fertilizantët organike dhe plehu organik:

1. Futen në treg dhe të shpërndahen nga tregtarë të regjistruar sipas nenit 23, paragrafi i parë, i shtojcës së parë, të këtij vendimi.
2. Futen në treg, me kusht që në ambalazh ose në etiketë të jetë shkruar numri i licencës së impiantit që i ka prodhuar ose i impiantit që i ka ambalazhuar, dhe për fertilizantët dhe plehun organik që vjen nga importi është i shkruar numri i licencës së importuesit.

3. Prodhimi i fertilizantëve organike dhe plehut organik sipas përshkrimeve të nenit 32, të shtojcës së parë, bëhet duke respektuar kërkesat e nenit 22 dhe kërkesat e aneksit XI, të shtojcës së dytë, të këtij vendimi. Në veçanti fertilizantët organike dhe plehu organik:
  - a) i nënshtrohen metodës së transformimit 1, kur rrjedhin nga materialet e kategorisë 2;
  - b) i nënshtrohen metodës së transformimit 1, nëse rrjedhin nga proteina shtazorë të transformuara të destinuara për prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimin;
  - c) i nënshtrohen njëres nga metodat e transformimit nga 1 në 7, nëse rrjedhin nga materiale të kategorisë 3, dhe që nuk janë proteina shtazore të transformuara.
  - d) përzihen para se të futen në treg ose të shpërndahen në një impiant të prodhimit të fertilizantëve organike dhe të plehut organik, me një substancë sipas kërkesave të aneksit XI, kapitulli II, seksioni 1, pika 3 shkronja a) të aneksit 2, të shtojcës së parë, të këtij vendimi.
  - e) futen në treg, me kusht që në paketim ose në kontenitor ose në mjetin e transportit dhe në dokumentin tregtar të shkruhet dicitura *“Fertilizantë organike ose pleh organik. Për të paktën 21 ditë pas aplikimit në tokë, është e ndaluar që kafshët që prodhojnë ushqim, të ushqehen në kullotë, ose me barin e marrë nga kullota”*.
  - f) detyrimet e pikave d) dhe e) nuk zbatohen për:
    - i) paketimet e gatshme për përdorim, me peshë më të madhe se 40 kg të destinuara direkt tek përdoruesi final sipas përshkrimeve të Aneksit XI, kapitulli II, seksioni 4, shkronja a) të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
    - ii) paketimet në “big-bag” me peshë jo më të madhe se 1000 kg ose për paketimet e fertilizantëve në formë të lëngshme në kontejnerë me kapacitet jo më të lartë se 1000 litra, me kusht që, kur bëhet fjalë për ferma të cilat mbarështojnë kafshë marrim me parë autorizim nga autoriteti kompetent për përdorimin e tyre. Sidoqoftë në paketime ose në kontejner shkruhet dicitura: **“Nuk përdoret në terrene në të cilat mund të hyjnë kafshët që prodhojnë ushqim”**.
  - g) detyrimi i përcaktuar në pikën d) nuk kërkohet për proteinat e hidrolizuara sipas aneksit I, pika 14 e të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
  - h) detyrimi i përcaktuar në pikën e) nuk kërkohet për proteinat e hidrolizuara dhe të përfituara sipas përshkrimeve të aneksit X, pjesa III, seksioni 5, shkronjat a) dhe d) të shtojcës së dytë 2, të këtij vendimi.
4. Në përputhje me aneksin VIII, kapitulli IV, seksioni 4, personi përgjegjës për terrenin ku kultivohen ushqime foragjere, në të cilin përdoren fertilizantë organikë dhe pleh organik me përjashtim të plehut të stallës, të glasave dhe të përmbajtjes së aparatit tretës, qumështit dhe produkteve me bazë qumështi, kulloshtrë dhe produkteve me bazë kulloshtrën, është i detyruar të regjistrojë:
  - a) sasinë e fertilizantëve organike ose të plehut organik të përdorur në terren;
  - b) datën e aplikimit në terren dhe zonën në të cilën është bërë aplikimi;
  - c) datën pas aplikimit në të cilën është hapur kullotja ose është mbledhur masa e gjelbër për ushqim për kafshë.
 Regjistrat druhen për një kohe prej të paktën dy vite.
5. Plehu i stallës, përfshirë lëngjet e rrjedhura të kompleksit të mbarështimit dhe përmbajtja e aparatit tretës të kafshëve e ndarë nga vetë aparati tretës mund:



- a) aplikohen direkt në terren pa pësuar transformim paraprak në impiantet e licencuar sipas kërkesave të shtojcës së parë, të këtij vendimi, nëse autoriteti kompetent veterinar, vendos që nuk paraqet rrezikun e përhapjes së sëmundjeve të renda të transmetueshme;
- b) janë të destinuara për prodhimin e biogaz ose të kompost në impiante të vendosura në të njëjtën fermë-blegtorale që i prodhon ato;
- c) janë të destinuara për prodhim të biogaz ose kompost në impiante të licencuar sipas nenit 24, paragrafi i parë, shkronja g) dhe të normativave mbi ambientin;
- d) të destinuara për prodhimin e fertilizantëve ose të plehut të stallës të transformuar në impiante të licencuar;
- e) transportohen në kontejner ose mjete transporti që mbajnë diciturën “**Pleh stalle**” sikurse përshkruhet në aneksin VIII, kapitulli II, pika 2 (XIII) të shtojcës së dytë, të këtij vendimi.
- f) depozitohet në struktura të përshtatshme, në thertore, në komplekset e mbarështimit të kafshëve ose në impiantin e përpunimit të tyre i cili përcaktohet nga vetë thertoret ose komplekset e mbarështimit nëpërmjet një kontrate.

#### **Neni 15** **Masa ndaluese**

1. Është e ndaluar hedhja e nënprodukteve shtazore, derivateve të tyre dhe mbetjeve me prejardhje shtazore:
  - a) në vende që nuk janë autorizuar nga autoritetet kompetente;
  - b) në mjediset urbane: në sheshe, në rrugë, në kazanët e mbledhjes së mbetjeve urbane;
  - c) në det dhe në basene ujore natyrale dhe artificiale: të gjitha nënproduktet me prejardhje nga kafshët e tokës dhe të gjitha nënprodukteve me prejardhje nga kafshët e ujit, me përjashtim të nënprodukteve që janë të përpunuara si ushqim për peshqit në basenet e mbarështimit të tij.
2. Në mjediset rurale është e ndaluar hedhja, groposja, braktisja dhe djegia e nënprodukteve shtazore në fusha, në kodra, në pyje dhe çdo ambient tjetër rural.
3. Është e ndaluar braktisja e kadavrave të kafshëve të shoqërimit. Asgjësimi i tyre bëhet nga:
  - a) qytetarët që:
    - i) i groposin ato, kur bëhet fjalë për kafshë të madhësive të vogla deri në 10 kg, në ambientet e tyre private në mënyrë që të mos ndotin ambientin dhe kur kanë mundësi ta bëjnë pasi zotërojnë kopshte dhe oborre me sipërfaqe më të madhe se 500 m<sup>2</sup>, ose
    - ii) i dorëzojnë ato tek një qëndër e grumbullimit të kadavrave ose e grumbullimit të nënprodukteve me origjinë shtazore ose një klinikë veterinare ose spital veterinar, të cilët janë të detyruar t'i pranojnë dhe asgjësojnë sipas kërkesave të këtij vendimi. Klinikat dhe spitalet veterinare lidhin një kontratë për asgjësimin e nënprodukteve shtazore që prodhohen, sipas kërkesave të këtij vendimi, ose
    - iii) i dorëzojnë ato direkt në një landfill të autorizuar.
  - b) Njësitë e qeverisjes vendore mbledhin kadavrat e kafshëve endacake të ngordhura dhe i asgjësojnë sipas kërkesave të këtij vendimi. Njësitë e qeverisjes vendore i bëjnë të ditur Autoritetit kompetent të përcaktuar në pikën 1 germa b të nenit 3 të këtij vendimi, landfillin ose impiantin në të cilin ata asgjësojnë mbeturinat shtazore.

10. Veprimtaritë e përshkruara në nenin 11, të shtojcës së parë, të këtij vendimi janë të ndaluara.
11. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, strukturave përgjegjëse të inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, marrin masa për zbatimin e parashikimeve të këtij neni, në përputhje me pikën 34, të nenit 62 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
12. Është e ndaluar mbledhja, ruajtja, magazinimi dhe transporti i nënprodukteve shtazore në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 pika 1.

## Neni 16

**Importi, eksporti dhe transiti i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate**  
Importi, eksporti dhe kalimi transit i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate kryhet kur nënproduktet shtazore dhe produktet derivate janë prodhuar në respekt të parimeve dhe përshkrimeve të nenit 4, të shtojcës së parë dhe kapitullit të VIII të shtojcës së dytë, të këtij vendimi. Përveç sa përshkruhet më sipër, në territorin e Republikës së Shqipërisë:

1. Është e ndaluar të importohen nënprodukte të kategorisë 1(një) ose produkte derivate që rrjedhin prej tyre.
2. Është e ndaluar të importohen nënprodukte të kategorisë 1(një) dhe kategorisë 2(dy), për t'u përpunuar ose/dhe asgjësuar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Është i ndaluar importi i nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe derivateve të tyre të cilat janë të cilësuar si mbeturina me origjinë shtazore ose që rezultojnë të tilla gjatë kontrollit zyrtar ose inspektimit në Pikën e Kontrollit Kufitar.
4. Autoriteti doganor para se të kryejë veprimet doganore me një mall që është nënprodukt shtazor ose produkt derivat kërkon dhe merr miratimin e Autoritetit të përcaktuar në pikën 1 gema c, të nenit 3 të këtij vendimi. Autoriteti doganor lejon hyrjen e mallit në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm pasi merr miratimin e tij.
5. Importi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate nga operatorët që prodhojnë përpunojnë dhe tregtojnë nënprodukte shtazore ose produkte derivate:
  - a) nga territori i secilit nga vendet e anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të regjistruara në sistemin TRACE të Komisionit Evropian. Ato i bëjnë autoritetit kompetent një kërkesë sipas kërkesave të shtojcës së parë dhe shtojcës së dytë të këtij vendimi duke përdorur formularin e përshkruar në seksionin 10, kapitulli III, aneksi XVI i shtojcës së dytë të këtij vendimi. Autoriteti kompetent, i përcaktuar në pikën 1 germa ç) të nenit 3 të këtij vendimi, i përgjigjet operatorit që ka bërë kërkesën duke pranuar, pranuar me kusht ose refuzuar importin e mallit dhe duke arsyetuar refuzimin ose kushtet e vendosura.
  - b) nga territori i vendeve janë anëtare të Marrëveshjes CEFTA që prodhojnë përpunojnë e tregtojnë nënprodukte shtazore ose produkte derivate të territorin shtetëror të tyre dhe:
    - i) janë të regjistruara në sistemin TRACES të Komisionit Evropian bëjnë një kërkesë autoritetit kompetent i përcaktuar në pikën 1 germa ç) të nenit 3 të këtij vendimi, duke përdorur formularin e përshkruar në seksionin 10, kapitulli III, aneksi XVI i shtojcës së dytë të këtij vendimi. Autoriteti kompetent i përgjigjet operatorit që ka bërë kërkesën duke pranuar, pranuar

me kusht ose refuzuar importin e mallit dhe duke arsyetuar refuzimin ose kushtet e vendosura.

- ii) Kur nuk janë të regjistruara në sistemin TRACES të Komisionit evropian i bëjnë kërkesë të autoritetit kompetent për të arritur një marrëveshje tregtare sipas përcaktimeve të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” dhe marrëveshjes CEFTA. Importi kryhet vetëm kur Autoritet kompetente e të dy shteteve arrijnë një marrëveshje.
  - iii) kërkesa bëhet në përputhje me përshkrimet e aneksit VII, të shtojcës së dytë të këtij vendimi.
- c) Importuesit shqiptare importojnë nënprodukte shtazore nëse:
- i) importuesi është i regjistruar në sistemin TRACES dhe prodhuesi, përpunuesi ose tregtuesi i vendit i cili ushtron aktivitetin e tij në territorin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ose në territorin shtetëror të një vendi të tretë dhe është i regjistruar në sistemin TRACES nuk nevojitet të marrë miratimin autoritetit kompetent sipas përshkrimit. Importi bëhet në bazë të kushteve të përcaktuara në aktin e regjistrimit në sistemin TRACES;
  - ii) importuesi, kur nuk është i regjistruar dhe/ose prodhuesi, përpunuesi, tregtuesi i cili ushtron aktivitetin e tij në territorin e një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian ose në territorin shtetëror të një vendi të tretë nuk është i regjistruar në sistemin TRACES, i kërkon autoritetit kompetent, arritjen e një marrëveshje me autoritetin kompetent të shtetit eksportues. Importi kryhet vetëm kur autoritet kompetente e të dy shteteve arrijnë një marrëveshje.
- d) për të gjitha rastet e tjera që nuk përshkruhen në pikat a), b) dhe c) të këtij neni importuesi shqiptar ose eksportuesi i një vendi që nuk është anëtar i Bashkimit evropian ose i marrëveshjes CEFTA i kërkon autoritetit kompetent, arritjen e një marrëveshje me vendin eksportues. Importi kryhet vetëm kur autoritet kompetente e të dy shteteve arrijnë një marrëveshje.
6. Eksporti i nënprodukteve shtazore nga operatorë që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë që:
- a) janë të regjistruar në sistemin TRACES, eksportojnë sipas kushteve të regjistrimit në sistem.
  - b) nuk janë të regjistruar në sistemin TRACES, i kërkojnë autoritetit kompetent, arritjen e një marrëveshje me vendin importues. Eksporti kryhet vetëm kur autoritet kompetente e të dy shteteve arrijnë një marrëveshje.
7. Transiti i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate nga dhe për në vendet e Bashkimit evropian ose nga dhe për në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet në përputhje me kërkesat e shtojcës së parë të këtij vendimi ose në bazë të marrëveshjeve dypalëshe. Autoriteti kompetent i vendos një vullë shtesë në pikën kufitare hyrëse, e cila do të kontrollohet që të jetë e pa prekur në pikën kufitare dalëse.

8. Importi dhe transiti i nënprodukteve shtazore të cilat janë të destinuara të futen në zinxhirin e ushqimeve për kafshët, plotëson normat e përshkruara aneksin XIV të shtojcës së dytë të këtij vendimi.
9. Është i lejuar importi i nënprodukteve shtazore ose/dhe produkteve derivate kur plotësojnë kërkesat e nenit 28 të shtojcës së dytë të këtij vendimi me kusht që pas përfundimit të aktivitetit të kthehen në vendin e origjinës ose të eliminohen si nënprodukte shtazore e kategorisë 1. Importuesi deklaron në kërkesën për import se cilën mënyrë eliminimi do të përdorë.

#### **Neni 17**

##### **Kontrollet zyrtare dhe inspektimet**

1. Kontrollet dhe inspektimi zyrtar për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi, bazohen në legjislacionin për kontrollin dhe inspektimin zyrtar të ushqimit dhe shërbimit veterinar duke u mbështetur edhe në kërkesat e nenit 32 të shtojcës së dytë të këtij vendimi.
2. Inspektimi për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe të inspektimit
3. Kontrolli i impianteve dhe stabilimenteve mbi vend vendosjen dhe plotësimin e kërkesave teknike dhe funksionimin e tyre, të përcaktuara në shtojcën e dytë të këtij vendimi, kryhen nga Autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij vendimi.

#### **Neni 18**

##### **Marrja e masave alternative**

Përveç sa parashikohen në këtë vendim, Autoritetet kompetente brenda fushës së përgjegjësisë që ato kanë, marrin masa alternative të përkoshme dhe vetëm për rastet e parashikuara në shtojcën parë në: pikën 3 të nenit 5; pikën 2 të nenit 11; nenin 15; nenin 17; pikën 2 të nenit 18; pikën 4 të nenit 19; pikën 2 të nenit 21; nenin 27; nenin 30; pikën 3 të nenit 32; nenin 40; nenin 42; nenin 44, të këtij vendimi.

#### **Neni 19**

##### **Kundërvajtje administrative**

Kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative veprimet që vijojnë:

1. Përdorimi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, paragrafi 1, gërmat a) dhe d) të shtojcës së parë.
2. Përdorimi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, paragrafi 1, gërmat b) dhe c) të shtojcës së parë dhe të kërkesave të aneksit II, kapitulli II i shtojcës së dytë.
3. Eliminimi ose përdorimi i materialeve të kategorisë 1, pa përmbushur kërkesat e nenit 12, paragrafi 1, i shtojcës së parë.
4. Eliminimi ose përdorimi i materialeve të kategorisë 2, pa përmbushur kërkesat e nenit 13, paragrafi 1, i shtojcës së parë.
5. Eliminimi ose përdorimi i materialeve të kategorisë 3, pa përmbushur kërkesat e nenit 4, paragrafi 1, të shtojcës së parë.

6. Mosrespektimi i kërkesave të nenit 21, paragrafi 1, i shtojcës së parë dhe përshkrimeve të aneksit VIII, kapitulli II, të shtojcës së dytë.
7. Mos respektimi i kërkesave të nenit 21, paragrafët 2 dhe 3, i shtojcës së parë dhe përshkrime vetë aneksit VIII, kapitulli III, të shtojcës së dytë.
8. Mosrespektimi i kërkesave të nenit 21, paragrafi 4, i shtojcës së parë.
9. Operatorët që sipas kërkesave të nenit 22 paragrafi i parë, i shtojcës së parë nuk mbajnë regjistra të partive të dërguara ose/dhe të marra ose nuk mbajnë ose/dhe nuk janë të pajisur me certifikata sanitare sipas përshkrimeve të aneksit VIII, kapitulli IV i shtojcës së dytë dhe nuk figurojnë mënyrën e gjurmimit të partive të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate.
10. Mosmarkimin e materialeve sipas kërkesave të aneksit VIII, kapitulli V, të shtojcës së dytë.
11. Mos njoftimi i Autoritetet kompetente, sipas nenit 23, të shtojcës së parë, për fillimin e veprimtarisë prodhuese pasi ka marrë licencën ose ka ndaluar në mënyrë vullnetare aktivitetin, në stabilimentet dhe impiantet që ai zotëron ose vazhdon veprimtarinë atëherë kur licenca i është pezulluar ose hequr.
12. Mospërditësimi i licencës kur janë kryer modifikime në impiante ose/dhe në procesin e prodhimit sipas 23, paragrafi 2, i shtojcës së parë të këtij vendimi.
13. Moslidhja një kontratë bashkëpunimi me një impiant të licencuar sipas kërkesave të nenit 5 të këtij vendimi.
14. Mosplotësimi i kërkesve të aneksit IV kapitulli I, seksioni 1, të shtojcës së dytë.
15. Mosplotësimi i kërkesve të aneksit IV, kapitulli I, seksioni 2, të shtojcës së dytë, përsa i përket ujërave të kullimit.
16. Mosplotësimi i kërkesve specifike të transformimit të materialeve të kategorisë 1 dhe 2, të parashikuara nga aneksi IV, kapitulli I seksioni 2, i shtojcës së dytë.
17. Mosplotësimi i kërkesve specifike të transformimit të materialeve të kategorisë 3, të parashikuara nga aneksi IV, kapitulli I, seksioni 4, i shtojcës së dytë.
18. Mosplotësimi i kërkesve të prodhimit të biogas dhe të kompostit, të parashikuara nga aneksi V, kapitulli I seksionet 1 dhe 2, i shtojcës së dytë.
19. Mosplotësimi i kërkesve në fushën e higjienës për impiante të prodhimit të biogas dhe kompostit, të parashikuara nga aneksi V, kapitulli II i shtojcës së dytë.
20. Mosplotësimi i parametrave standarde të transformimit, të parashikuara nga aneksi V, kapitulli III seksionet I, i shtojcës së dytë. Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara nga aneksi VIII, kapitulli III, seksionet 1 dhe 2, të shtojcës së dytë.
21. Mosplotësimi i kërkesve të mbetjeve të traktit tretës dhe të kompost, të parashikuara nga aneksi V, kapitulli III, seksioni 3, i shtojcës së dytë.
22. Mosplotësimi i kërkesve të përgjithshme në stabilimentet dhe impiantet e tyre, në fushën e higjienës dhe transformimit, të parashikuara nga neni 25, paragrafi dhe aneksi IV, kapitujt II, III dhe IV, të shtojcës së dytë.
23. Mosplotësimi i kërkesve në fushën e përpunimit të nënprodukteve shtazore sipas përshkrimeve të nenit 26, të shtojcës së parë.
24. Mosplotësimi i kërkesve, mbajes dhe ndjekjes së sistemeve të kontrollit të brendshme ose/dhe mosmarrja e masave që një nënprodukt shtazor të dalë nga impianti ose stabilimenti i pa përpunuar ose/dhe i pa regjistruar, të parashikuara nga neni 28 i shtojcës së parë.

25. Mosplotësimi i kërkesve të hartimit, mbajtjes dhe zbatimit planeve të autokontrollit të bazuar në principet e sistemit HACCP, siç parashikohet nga neni 29, paragrafi 1, i shtojcës së parë.
26. Futja në treg nënprodukte shtazore dhe produkte derivate të destinuara për kafshët e mbarështimit, me përjashtim për ushqimet e destinuara për kafshët e prodhimit të gëzofëve, pa respektuar kërkesat e nenit 31, të shtojcës së parë dhe të aneksit X, të shtojcës së dytë.
27. Futja në treg dhe përdorimi fertilizanteve organike dhe pleh organik pa respektuar kërkesat e nenit 32, të shtojcës së parë dhe të aneksit XI të shtojcës së dytë.
28. Futja në treg e ushqimit për kafshët e shoqërimit pa respektuar kërkesat e nenit 35, të shtojcës së parë.
29. Futja në treg produkteve derivate pa respektuar kërkesat e përgjithshme sipas përshkrimeve të neneve 36, 37, 38, dhe 38 të shtojcës së parë.
30. Përdorimi i materiale të kategorisë 1, sipas nenit 8, gërmat a), b), d) dhe e), sipas kërkesave të nenit 24, paragrafi i parë, i shtojcës së dytë.
31. Futja në treg një nënprodukti shtazor ose një produkt derivat, pa plotësuar kërkesat specifike të aplikueshme për proteinat shtazore të transformuara dhe për produktet e tjera derivate, sipas përshkrimeve të aneksit X, kapitulli II, të shtojcës së dytë, me përjashtim që aneksi XIII i shtojcës së dytë pa parashikuar kushte specifike për këto produkte sipas kërkesave të nenit 24, paragrafi i parë.
32. Mosplotësimi i kërkesave të nenit 24, paragrafi 3 dhe 4, i shtojcës së dytë dhe kërkesat e aneksit XIII, të shtojcës së dytë.
33. Futja në treg, importimi i lëkurë të kafshëve, të cilat i janë nënshtruar një trajtimi mjekësor veterinar të paligjshmen, zorrë të ruminanteve me ose pa përmbajtje, kocka ose produkte me bazë kockat që përmbajnë kockat e shtyllës kurrizore dhe të kafkës, pa autorizimin përkatës, sipas përshkrimeve të nenit 26 të shtojcës së dytë.
34. Importimi ose/dhe eksportimi i nënprodukteve shtazore dhe produkte derivate me qëllim eliminimin nëpërmjet groposjes ose djegies.
35. Përbëjnë kundervajtje administrative veprimet ose mosveprimet në kundërshtim me kërkesat nenit 12: pika 8 gërma a dhe gërma b, pika 10, pika 11, pika 12, pika 14, pika 16.
36. Autoritetet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij vendimi, kur gjatë kontrollve zyrtare gjejnë kundervajtjet e përshkruara më sipër, marrin masa administrative sipas kërkesave të pikës 34, të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

## **Neni 20**

### **Dispozita të fundit**

Ngarkohen Ministria përgjegjëse për mjedisin, Ministria përgjegjëse për veterinarinë së bashku me strukturat e varësisë së tyre, strukturat doganore dhe strukturat përgjegjëse të policisë së shtetit dhe të policisë bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me 1 janar 2023.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi RAMA**